



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 75, Datë 26.03.2018**

**MBI**

**DETYRIMIN E SHOQËRISË OSHEE SH.A PËR NËNSHKRIMIN E “KONTRATËS TIP PËR SHITBLERJE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET OSHEE SH.A DHE PRODHUESVE ME PËRPARËSI TË ENERGJISË ELEKTRIKE” TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 101, DATË 23.06.2016 TË BORDIT TË ERE, I NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 147, DATË 30.09.2016 TË BORDIT TË ERE.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, gërma “h” të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.03.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike në lidhje me fillimin e procedurës për shqyrtimin e disa shtesave dhe ndryshimeve të propozuara nga shoqëria OSHEE sh.a në “Kontratën Tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a dhe Prodhuesve me Përparësi të energjisë elektrike” të miratuar me vendimin nr. 101, datë 23.06.2016 të bordit të ERE, i ndryshuar me vendimin nr. 147, datë 30.09.2016 të bordit të ERE,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE me vendimin nr. 101, datë 23.06.2016 ka vendosur për miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE) miratuar me vendimin nr. 80 datë 23.10.2009, të ndryshuar.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 147, datë 30.09.2016, ka vendosur për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike midis OSHEE dhe PPE të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 101, datë 23.06.2016.
- Në zbatim të parashikimit të “Kontratës Noteriale” të nënshkruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Prodhuesit me Përparësi të energjisë elektrike, detyrohet që “OSHEE” sh.a brenda datës 28 Janar 2018 të nënshkruajë kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike me Prodhuesin me Përparësi të energjisë elektrike, Seman Sunpower.
- Shoqëria OSHEE sh.a më shkresën nr. 902 Prot., datë 16.01.2018, (protokolluar në ERE më datë 18.01.2018, me nr. 70 Prot.) ka kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Enti Rregullator i Energjisë udhëzim dhe orientim lidhje me këtë situatë si dhe hapat që duhet të ndërmarrë Shoqëria “OSHEE” sh.a.
- ERE në cilësinë e rregullatorit ka detyrimin të garantojë mbarëvajtjen normale të kësaj kontrate midis OSHEE sh.a dhe Prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike. Si e

tillë për të mos penguar punën e OSHEE dhe PPE–ve në zbatimin e kësaj kontrate, lind nevoja e nënshkrimit të saj nga palët sipas afateve të vendosura në kontratën/autorizim, me mbajtësin e miratimit përfundimtar nga Ministria përgjegjëse për ndërtimin e impianteve nga burimet e rinovueshme.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE :

**Vendosi:**

1. Shoqëria OSHEE sh.a të nënshkruajë brenda afateve të vendosura në kontratë/autorizim, me mbajtësin e miratimit përfundimtar nga Ministria përgjegjëse për ndërtimin e impianteve nga burimet e rinovueshme, Kontratën Tip të shitblerjes së energjisë elektrike të miratuar nga ERE me Vendimin nr. 101, datë 23.06.2016.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**